



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Vlorë më, 11. 07. 2019

**VENDIM**

**Nr. 35, datë 11. 07.2019**

**PËR  
PËRCAKTIMIN E KATEGORISË SË PAGAVE TË PERSONELIT AKADEMIK TË  
UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE**

Mbështeturnë nenin 49 dhe 59të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM-së Nr. 748, datë 11.06.2009 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë" i ndryshuar me VKM-në Nr. 268/2017, Vendimin Nr. 21, datë 05. 06. 2019 të Senatit Akademiksi dhe nëshkresën e Administratorit Nr. 761/ 2 prot., datë 02.07.2019, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 11. 07. 2019,

**VËREN SE:**

Nga Administratori i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, është depozituar për shqyrtim shkresa me Nr. 761/2 Prot., datë 02.07.2019 me anë të cilës përcillen efektet financiare të Vendimit Nr. 21, datë 05.06.2019 të Senatit Akademik. Në Vendimin në fjalë Senati Akademik nisur nga kërkesa e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, me shkresën Nr. 761 prot., datë 03.06.2019, ka vendosur pagesat për kategoritë e stafit akademik "Lektorë", "Asistent Lektorë" dhe "Të ftuar", duke i kërkuar Bordit të Administrimit, miratimin e mëtejshëm.

Për sai përket pikës së parë të Vendimit nr.21, vihet re se Senati Akademik ka vendosur që për kategorinë Lektorë, të parashikuar në nenin 59, pika 4 e Ligjit nr. 80/2015, pagesa të jetë në vlerën 95.800 lekë sipas lidhjes nr.1 të VKM-së nr.268/2017, nr. rendor 13.

B.A pas shqyrtimit të legjislacionit konstaton se nr. rendor 13 i VKM nr.268/2017, përcakton pagesën për kategorinë e stafit akademik Docent (me gradën Doktor), ndërkohë që pagat e kategorisë Lektorë, përcaktohen në nr. 15 dhe 16 të VKM-së në fjalë.

Në fakt neni 59 i ligjit nr. 80/2015 e klasifikon stafin akademik në tre kategori: a) Profesorë, b) Lektorë dhe c) Asistent - Lektorë, ndërkohë që VKM-ja nr.268 e datës 29.03.2017, e cila ndryshon VKM-në nr. 748, datë 11.06.2009, nuk reflekton kategorizimin e personelit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

akademik sipas nenit 59 të ligjit të Arsimit të Lartë (nr. 80/2015), fakt ky i konstatuar dhe nga grupi i auditit të MASR, në raportin përfundimtar mbi "Vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, i riskut dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime, në arritjen e objektivave", dërguar me shkresë nr. 4609/4 datë 19.07.2018. Pavarësisht këtij fakti, kategoria e stafit akademik Lektor, nuk mund të konsiderohet si Docent, pasi në Dispozitat kalimtare dhe të fundit të ligjit nr. 80/2015 dhe më konkretisht në nenin 126, parashikohet e kundërta, kategoria Docentë konsiderohet si Lektor (pagesat e të cilëve përcaktohen në nr. rendor 15 dhe 16 të VKM nr. 268/2017) dhe kategoria Lektor konsiderohet si Asistent - Lektorë (e pa reflektuar në VKM nr. 268/2017).

Në pikën e 3 të Vendimit nr.21, Senati Akademik ka përcaktuar pagën e pedagogëve të ftuar konform parashikimit të pikës 7 të VKM nr.268/2017, e cila ndryshon VKM nr. 748, datë 11.06.2009 dhe i ka kërkuar BA-së, të përcaktojë masën e pagesës konform pikës 9, të VKM nr. 748, datë 11.06.2009 e ndryshuar, në të cilën parashikohet se pagesa për Personelin akademik me kontratë nga kategoria Akademikë dhe Profesorë nuk duhet të jetë më shumë se 5-fishi i pagesës së orëve mbi normë (të përcaktuara në pikën 7 të VKM së sipërcituar).

Bordi i Administrimit në vendimarrjen e tij, merr parasysh efektet financiare, të cilat përballohen nga të ardhurat e vet IAL-së, që duhet të jenë të tilla sa të mos çënojnë qëndrueshmërinë financiare të Universitetit, por edhe faktin se një pagesë në nivelin minimal të përcaktuar nga V.K.M-ja, do të bënte të pamundur afrimin e personaliteteve të shquara (Akademikë dhe Profesorë) si pedagog me kontratë, duke humbur në këtë mënyrë në cilësi dhe konkurrueshmëri.

Nga sa u parashtrua mësipër, në përfundim Bordi Administrimit në mbledhjen e datës 11.07.2019,

**VENDOSI:**

1. Të mos pranojë propozimin e pikës 1 të Vendimit nr.21, të Senatit Akademik për ndryshimin e kategorisë së pages për personelin akademik të kategorisë "Lektor", si të pa bazuar në ligj dhe aktet nënligjore.
2. Të pranojë propozimin e pikës 2 të Vendimit nr.21 të Senatit Akademik, që për personelin akademik të kategorisë "Asistent- lektorë", strukturat përgjegjese pranë UV-së t'i drejtohen Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për t'u shprehur për kategorinë e pagës.
3. Të pranojë propozimin e pikës 3 të Vendimit nr. 21, të Senatit Akademik dhe të miratojë pagesën e personelit akademik me kontratë, si mëposhtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

- a. Kategoria "Profesor", përfiton 1 320 lekë për çdo orë 60 minutëshe
- b. Kategoria "Profesor i Asociuar", përfiton 1 210 lekë për çdo orë 60 minutëshe
- c. Kategoritë e mësipërme përfitojnë 2- fishin e pagasave të përcaktuara.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë dhe Drejtoria e Shërbimeve mbështetëse.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Kopje e këtij Vendimi i përcillet për dijeni Senatit Akademik.
7. Bashkëlidhur këtij vendimi vendoset kopje e shkresës nr. 761/2 prot., datë 02.07.2019, relacioni i Administratorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, si dhe dokumentacioni shoqërues.

Anjeza Shiko – Anëtar

Rajmonda Simoimeri – Anëtar

Enrik Mehmeti – Anëtar

Dr. Elsjed Rexhaj – Anëtar

Dr. Enida Pulaj – Anëtar

Dr. Marinela Muço – Anëtar

Dr. Ervis Moçka – Kryetar

